REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. ____ prot. Tiranë, më ___ . ___ . 2020

Lënda: Mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - prill 2020

Në zbatim të pikave 2 dhe 3, të nenit 19, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", po ju parashtrojmë dokumentin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për periudhën janar - prill 2020, miratuar me vendimin nr. 03 prot, datë 21.05.2020, të Mbledhjes së Grupit për Menaxhimin Strategjik.

Në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ligjit nr. 88/2019 "Për Buxhetin e vitit 2020", udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka përgatitur Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për periudhën janar - prill 2020, sipas kësaj shkrese dhe dokumenteve bashkëlidhur.

Monitorimi është një proces vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar. Në kuadër të menaxhimit financiar, monitorimit i kushtohet një vëmendje e veçantë si një nga 5 komponentët shumë të rëndësishëm të kontrollit të brendshëm. Monitorimi për veprimtarinë institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për 4- mujorin e parë të vitit 2020, është kryer në kuadër të një analize krahasimore plan-fakt sa i përket produkteve të përcaktuar dhe zërave të shpenzimeve, dhe planifikimit të buxhetit në Projekt Buxhetin Afatmesëm (2020-2022).

Në kërkesat buxhetore për vitin 2020, Kolegji i Posaçëm të Apelimit ka përcaktuar si produkt kryesor në realizimin e objektivit, "Çështje të ankimuara/shqyrtuara" me një plan vjetor në masën 90 (nëntëdhjetë) çështje. Gjatë periudhës janar - prill 2020, Kolegji i Posaçëm të Apelimit ka marrë në shqyrtim 12 (dymbëdhjetë) çështje me një realizim prej 13.3 %. Ky nivel i ulët realizimi ka ardhur si pasojë e situatës së fatkeqësisë natyrore dhe ndërprerjes së procesit gjyqësor gjatë periudhës mars-prill 2020.

Fondet buxhetore të akorduara nga buxheti i shtetit në zbatim të ligjit nr. 88/2019 "Për buxhetin e vitit 2020", për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, për vitin 2020, janë përcaktuar në vlerën ***127 (njëqind e njëzet e shtatë) milionë lekë***.

Plani i shpenzimeve buxhetore për periudhën janar-prill 2020 është ***51.95 milionë lekë.*** Realizimi i shpenzimeve buxhetore për periudhën janar-prill 2020 është ***38.7 milionë lekë*** ose ***75.2 %***. Shpenzimet buxhetore sipas artikujve kryesore paraqiten në tabelën në vijim.

000/lekë

Programi	Llogaria ekonomike	Emërtimi	Plani vjetor	Plani 4-mujor	Realizimi 4-mujor	% realizimit
03340	6000000	Paga	*96.700*	*38.300*	*34.113*	***89 %***
03340	6010000	Kontribute për sigurimet shoqërore, shëndetësore	*8.300*	*3.450*	*3.186*	***92 %***
03340	6020000	Mallra e shërbime	*20.000*	*9.700*	*1.405*	***15 %***
03340	2310000	Investime kapitale	*2.000*	*500*	*0*	***0 %***
		TOTALI	***127.000***	***51.950***	***38.705***	***75.2 %***

I - Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2020 në paga është ***96.7 milionë lekë*** dhe përbën rreth 76.1 % të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2020.
Buxheti i detajuar në paga, për periudhën janar- prill 2020, është ***38.3 milionë*** lekë.
Realizimi paraqitet në vlerën ***34.1 milionë*** lekë ose 89 % të planit 4/mujor dhe përfshin pagat e punonjësve të strukturës organike prej 43 (dyzet e tre) punonjës, të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 101, datë 04.10.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit" dhe pagat për 4 (katër) punonjësit me kontratë të përkohshmë pune. Në detajimin e buxhetit të kësaj periudhe në zërin paga është përfshirë dhe pagesa me një pagë mujore, si vështirësi për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor, për të cilin nuk ka pasur vendimmarrje nga Mbledhja e Gjyqtarëve, duke ndikuar dhe në masën e realizimit të këtij zëri të shpenzimeve.

II - Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2020 në sigurime shoqërore është ***8.3 milionë lekë*** dhe përbën 6.5 % të buxhetit total vjetor 2020. Buxheti i detajuar në zërin sigurime shoqërore, për periudhën janar- prill 2020, është ***3.4 milionë*** lekë. Realizimi paraqitet në vlerën ***3.2 milionë lekë*** ose 92 % të planit 4/mujor. Fondi për sigurimin është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit dhe në përpjesëtim të drejtë me shpenzimet për paga.

III - Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime (llogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihet një gamë e gjerë materialesh dhe shërbimesh të domosdoshme për mbështetjen e veprimtarisë institucionale. Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2020, në shpenzime operative është ***20 milionë lekë*** dhe përbën 15.7% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2020.
Buxheti i detajuar në shpenzime operative, për periudhën janar- prill 2020, është ***9.7 milionë*** lekë dhe realizimi ***1.4 milionë*** lekë ose 15 % të planit 4/mujor.
Në mënyrë të detajuar shpenzimet për mallra dhe shërbime paraqiten në tabelën në vijim:

MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA	**Realizimi viti 2020 (në lekë)**
Shpenzime për energji elektrike	**431.724**
Shpenzime për furnizimin me ujë	**12.960**
Shërbime telefonie	**67.947**
Posta dhe shërbim korrieri + abonim në shtypin e shkruar	**17.515**
Karburant për automjetin dhe gjeneratorin	**213.692**
Shërbime transporti (parkim për automjetin e institucionit + lavash + mirëmbajtje)	**198.000**
Shpenzime kompensimi për zyrtarët e zgjedhur (shpenzime telefonie)	**420.000**
Shpenzime kompensimi për zyrtarët e zgjedhur (pasaporta diplomatike)	**15.000**
Shpenzime te tjera	**29.091**
TOTALI	**1.405.929**

Gjatë kësaj periudhe janë plotësuar nevojat e institucionit për materiale të punës së përditshme si kancelari, letër, materiale pastrimi, mirëmbajte për pajisjet e printimit etj, me vlerë totale 982.731 lekë.

Është prokuruar shërbimi i telefonisë celulare për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor dhe drejtuesve të administratës, shërbime për automjetin e institucionit (vend parkim) si dhe karburant për automjetin dhe gjeneratorin me vlerë totale 547.859 lekë.

Janë shlyer detyrimet lidhur më shpenzimet për energji elektrike, furnizim me ujë dhe shpenzime postare (postim dokumentacioni, abonim në shtypin e shkruar) me vlerë totale 496.939 lekë.

Në zërin "Shpenzime kompensimi për zyrtarët e zgjedhur" me vlerë 435.000 lekë, janë pasqyruar vlerat e kompensuar gjyqtarëve për shpenzimet e telefonisë celulare, sipas kuotës 15.000 lekë/muaj, përcaktuar me vendim të Mbledhjes së Gjyqtarëve, nr. 2, datë 14.01.2019, dhe shpenzimeve për pajisje me pasaportë diplomatike.

Gjatë kësaj periudhe janë prokuruar licenca për aktivizimin e pajisjes *firewall* dhe programit "Zoom meeting", me vlerë totale 536.400 lekë.

Si pasojë e shpalljes së fatkeqësisë natyrore lidhur me COVID-19, në zbatim te vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243 datë 24.03.2020, si dhe njoftimit nr. 2339 prot, datë 27.03,2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, u ndërprenë procedurat e prokurimit në lidhje me sigurimin e jetës, shëndetit dhe pasurisë për gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, dhe furnizimit me tonera për institucionin, me vlerë totale rreth **5.7 milionë lekë.**

Gjithashtu në realizimin e kësaj periudhe nuk janë përfshirë pagesa në vlerën **1.6 milionë leke**, për shpenzime të kryera gjatë periudhës, janar-prill 2020, por të likuiduara në muajin maj të vitit 2020, si pasojë e bllokimit të pagesave nga dega e thesarit.

IV. Investime kapitale (431)

Buxheti i miratuar me ligj për vitin 2020 në investime është ***2 milionë lekë*** dhe përbën 1.6 % të buxhetit total vjetor. Buxheti i detajuar në zërin investime, për periudhën janar- prill 2020 është ***500 mijë*** lekë dhe realizimi ***0 (zero)***lekë ose 0 %.

Theksojmë se aktualisht Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka përmbushur nevojat për kompletimin me pajisje e poste pune për stafin dhe ambientet ekzistuese, me qëllim funksionimin normal të proceseve të punës.

Buxheti i miratuar do të përdoret për vënien në funksion të ambienteve në katin e parë të godinës, në momentin që këto ambiente do të lirohen nga përdoruesit aktualë sipas përcaktimeve ligjore.

Duke ju falënderuar për vëmendjen,